

**VENDIM**  
**Nr.456, datë 26.7.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.511, DATË 24.10.2002 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR KOHËZGJATJEN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË**  
**INSTITUCIONET SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19, shkronja “c”, 20, shkronjat “ë” dhe “g”, e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nënpunësit civil”, dhe neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 2 të kreut të I të vendimit nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Orari ditor i punës, për periudhën 30 korrik-27 gusht 2007, fillon çdo ditë në orën 8.00 dhe përfundon në orën 13.00.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**